



**KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI**
Prishtinë

www.kolegjibiznesi.com | info@kolegjibiznesi.com

038 500 878 | 044 500 878 | 049 500 878

Prishtinë, Ulpianë, rr. "Motrat Qiriaz" nr. 29

PLANPROGRAMI MËSIMOR-SYLLABUS							
Niveli i studimeve		Bachelor	Programi	Juridik i përgjithshëm		Viti Akademik	2020-21
Lënda		E DREJTA PENALE NDËRKOMBËTARE					
Viti	IV	Statusi i lëndës	Obligative	ECTS/kredi		7	
Semestri	VIII						
Javët mësimore		15		Orët mësimore	Ligjërata	Ushtrime	
					3	1	
Metoda e mësimi		Ligjërata, ushtrime, punime seminarike, konsultime, teste, detyra, etj.					
Konsultime		Një orë pas ligjëratave					
Mësimdhënësi		Dr. Muhamet Racaj		Tel/mob	0038970403532		
				e-mail	muhametracaj61@gmail.com		
Asistenti				Tel/mob			
				e-mail			
Qëllimi studimor dhe përmbajtja e lëndës				Përfitimet e Studentit			
Qëllimi i studimit të kësaj disipline juridike, ligjore aktuale dhe shkencore është që tu ofrojë studentëve të studimeve themelore njohuri thelbësore dhe të mjaftueshme lidhur me parimet dhe institutet themelore të së drejtës penale ndërkombëtare. Planprogrami është koncipuar në atë mënyrë që studentëve t’iu ofrojë njohuri bazike dhe mundësi për njohuri të thelluara për objektin e studimit të së drejtës penale ndërkombëtare në dy komponenta (qasje) kryesore, si vijon: E para, e drejta penale ndërkombëtare si degë e së drejtës pozitive dhe; E dyta, e drejta penale ndërkombëtare si degë e shkencave juridike, ose si disiplinë shkencore juridike. Gjatë ligjërimit të kësaj lënde mësimore, do të bëhen përpjekje të aplikohen metoda të ndryshme bashkëkohore interaktive, debatuuese dhe kreative, me qëllim që studentët ta përvetësojnë me sukses materien në lidhje me ekstradimin, azilin, pushtetin represiv, ndihmën juridike, bashkëpunimin policor ndërkombëtar, por edhe llojet e gjykatave ndërkombëtare si instrumentet ose mjete për luftimin e kriminalitetit ndërkombëtar, veprave penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare, deri tek përgjegjësia dhe instrumentet juridike për të zhvilluar procedurat penale, në kuadër të gjykatave ndërkombëtare.				1. Të kuptojmë se, në botën bashkëkohëse, është shumë vështirë të mendohet aprovimi i ligjeve (kodeve) sistemore në çdo fushë të së drejtës penale pa mbështetje edhe në parimet e së drejtës penale ndërkombëtare. 2. Në këtë lëndë mësimore, studentëve u ofrohen njohuri themelore për të drejtën penale dhe humanitare në përgjithësi dhe për të drejtën penale ndërkombëtare në veçanti. 3. Të kuptojnë të dhënë se institutet e së drejtës penale ndërkombëtare (vepra penale, përgjegjësia penale dhe sanksionet penale dhe institutet tjera të karakterit penal ndërkombëtar) janë institute me aktualitet të mprehtë për tërë botën, për Evropën, për regjionin, por edhe për Kosovën dhe qytetarët e saj. 4. Të njoftohen me faktin se e drejta penale në përgjithësi dhe e drejta penale ndërkombëtare në veçanti, kanë për objekt studimi veprën penale, përgjegjësinë penale, sanksionet penale dhe institutet tjera që janë të përcaktuara në kodet penale aktuale interne, në statutet penale ndërkombëtare dhe ne aktet tjera ndërkombëtare, e të cilat do të mësohen dhe studiohen në kuader të kësaj lënde mësimore, me qëllim që këto institute të bëhen më të qarta, më të kuptueshme dhe praktikisht më lehtë të zbatueshme. 5. Të kuptojnë të dhënë se, në kuadër të ligjëratave, ushtrimeve, debateve, prezenteve, punës me grupe, punimeve seminarike me shkrim dhe shqyrtimeve të instituteve të së drejtës penale ndërkombëtare, studentët do të marrin njohuri të shumta rreth: lëndës, funksionit, detyrës			

	dhe specifike të së drejtës penale ndërkombëtare, si disiplinë juridike dhe si disiplinë shkencore juridike, raporteve të kësaj discipline me disiplinat dhe shkencat tjera juridike, historikun e saj, burimet e së drejtës penale ndërkombëtare, interpretimin e instituteve të kësaj të drejte (veprën penale, përgjegjësinë penale, sanksionet penale dhe institutet tjera) të përmbajtura në kodet penale aktuale të vendëve të ndryshme dhe në aktet ndërkombëtare, por edhe në vet sistemet juridike të së drejtës.
METODOLOGJIA PËR REALIZIMIN E TEMAVE MËSIMORE	
Metoda e mësimdhënies aktive. Në mbështetje të kësaj metode shpjegohen, përkufizohen nocionet mbi institutet themelore të së drejtës së penale dhe të drejtës penale ndërkombëtare, interpretimi i drejtë dhe i qartë i tyre, e sidomos duke veçuar rëndësinë e jetësimit të drejtë dhe me kohë të së drejtës penale në përmasa kombëtare dhe ndërkombëtare. Metoda e mësimdhënies inter-aktive. Zhvillimi i hovshëm i shoqërisë së sotme, si dhe rritja me ritme marramendëse e informacionit, i ndihmuar nga mjetet e shumëllojshme të transmetimit e komunikimit masiv, kanë bërë të mundur që mësimdhënja të ndryshojë në mënyrë rapide. Pra, mësimdhënësi nuk është më burim i vetëm informacioni. Tani, ai është dhe duhet të jetë një udhëheqës dhe menaxher i mirë i procesit mësimor që drejton studentin për të hulumtuar në mënyrë të pavarur informacionin dhe me ndihmën e tij të zgjidhë çdo problem, pa marrë parasysh ndërlíkueshmërinë e tij. Meqenëse, në qendër të studimeve është dhe duhet të jetë studenti, atëherë mësimdhënësit i mbetet të aktivizoj studentin në dhënien e përkufizimeve dhe interpretimeve të parimeve kryesore dhe instituteve themelore dhe sistemeve të së drejtës penale në përgjithësi dhe të dejtës penale ndërkombëtare në vecanti. Kjo metodë ka për qëllim t’i mundësoj studentëve që gjatë studimeve, të jenë autonom në punën e tyre dhe të kuptojnë se institutet themelore të së drejtës penale ndërkombëtare, jo vetëm që janë fenomene juridike, por, ato janë edhe dukuri sociale-ngjarje që ndodhin në jetën e përditshme në përmasa kombëtare dhe ndërkombëtare. Metoda krahasuese. Kjo metodë u mundëson studentëve njohjen e instituteve juridike dhe krahasimin e tyre në kuadër të sistemeve juridike penale të vendeve të ndryshme që i perkasin familjeve ligjore të ndryshme me të drejtën penale ndërkombëtare. Kjo metodë ka për qëllim t’i njoftojë studentët edhe me raportet e së drejtës penale ndërkombëtare me disiplinat tjera juridike dhe me të drejtën penale krahasimor. Metoda e studimit të rasteve. Rëndësi të veçantë gjatë interpretimit dhe shpjegimit të instituteve themelore të së drejtës penale ndërkombëtare, ka studimi i instituteve të veçanta në të drejtën penale të vendeve dhe sistemeve të ndryshme juridike dhe institutëve të së drejtës penale ndërkombëtare. Këtu, studentët njoftohen në mënyrë praktike për punën e ardhshme të tyre dhe atë duke fokusuar tërë aktivitetin e tyre në studimin e instituteve të veçanta të së drejtës penale ndërkombëtare, institute këto të përmbajtura në kodet penale aktuale kombëtare, në statutet penale ndërkombëtare dhe në aktet tjera ndërkombëtare. Me ndihmën e kësaj metode, dispozitat e së drejtës penale ndërkombëtare bëhen më të afërta, më të dashura dhe zgjojnë kureshtjen e studentëve për të pasur informacione të mjaftueshme për parimet dhe institutet e kësaj discipline juridike. • Duke u nisur nga e dhëna se parimet dhe institutet e së drejtës penale ndërkombëtare kanë historikun e tyre, është me vlerë të veçantë edhe përdorimi i Metodës historike, sepse me ndihmën e kësaj metode studiohet historiku i parimeve dhe instituteve të së drejtës penale ndërkombëtare. Duke përdorur këtë metodë, studentët njoftohen me të dhënë, se parimet dhe institutet themelore të së drejtës penale në përgjithësi dhe të dejtës penale ndërkombëtare në vecanti, nuk kanë qenë të një shkalle të tashme të përkufizimit, por ky nivel i zhvillimit dhe përkufizimit të tyre është rezultat i një perpjekje e punës së vazhdueshme të shkencëtarëve dhe profesionistëve të së drejtës të një periudhe relativisht të gjatë dhe të mundimshme. Prezentimet, debatet dhe punimet seminarike, kanë një rëndësi të veçantë për studentët me rastin e nxënies së njohurive rreth parimeve kryesore dhe instituteve themelore të së drejtës penale ndërkombëtare. Këto kanë për qëllim thellimin e njohurive të studentëve lidhur me këto parime dhe institute, dhe për efekt zbatimin e tyre në praktikën gjyqësore të vendit dhe në përmasa ndërkombëtare. Gjatë ushtrimeve, studentëve iu parashtrihen pyetje konkrete, ku prej tyre kërkohet të bëjnë përpjekje për të menduar në mënyrë kritike dhe për të dhënë përgjigje adekuatë dhe për të zgjidhur rastin konkret në harmoni me dispozitat juridiko-penale të përmbajtura në aktet ndërkombëtare. Mësimdhënësi gjatë udhëheqjes së debateve dhe prezenteve duhet të krijoj kushte dhe atmosferë të atillë, që studentët të jenë në gjendje të bëjnë interpretimin e drejtë të normës juridike penale ndërkombëtare në mënyrë të lirshme, që ata të shprehën me një gjuhë të qartë, precize, koncize dhe pa ekuivoke, dhe së bashku me ta të vijë deri te zgjidhja e saktë e çështjes konkrete.	

Gjatë debateve dhe prezenteve, duhet të krijohet një atmosferë e volitshme për punë, ku studentët duke debatuar, duke shprehur ide dhe mendime vetanake dhe kritike rreth shumë parimeve dhe instituteve të së drejtës penale ndërkombëtare, aftësohen në zbatimin praktik të dispozitave juridike, e që kanë për efekt zgjidhjen e rasteve konkrete të rënda e shpesh të ndërlikuara që paraqiten në jetën e përditshme, në praktikën gjyqësore dhe gjatë ushtrimit të profesionit të juristit në fushat tjera të jetës juridike ndërkombëtare, shoqërore, politike dhe ekonomike. Me ndihmën e ligjeratave, debateve, prezenteve, seminareve me shkrim dhe mbrojtjes publike të tyre, punës në grupe, testeve dhe formave tjera të mësimdhënies dhe vlerësimit të njohurive gjatë gjithë semestrit, studentët aftësohen që në të ardhmen, në mënyrë të pavarur dhe në cilësinë e juristit profesionist, t'i sfidojnë sfidat që paraqiten në shumë fusha të së drejtës interne dhe ndërkombëtare.				
KUSHTET PËR REALIZIMIN E TEMËS MËSIMORE				
Salla e pajisur me kompjuter dhe projektor, tabela për ushtrimin e detyrave				
Mënyra e vlerësimit të studentit (në %):				
Vlerësimi i parë:..... 25% Vlerësimi i dytë 20% Punimi seminarik-Prezentimi 10% Vijimi i rregullt 5% Provimi final 40%	Vlerësimi në %	Nota përfundimtare		
	91-100	10 (dhjetë)		
	81-90	9 (nëntë)		
	71-80	8 (tetë)		
	61-70	7 (shtatë)		
	51-60	6 (gjashtë)		
OBLIGIMET E STUDENTIT				
Ligjërata	Ushtrime			
Vijimi i Ligjëratave Pjesëmarrje aktive, Punime seminarike, projekte, Pjesëmarrje ne teste dhe ushtrime, Provimi përfundimtar.	Pjesëmarrje ne ushtrime Puna individuale dhe grupore ne raste studimi, Pjesëmarrje diskutime.			
NGARKESA E STUDENTIT PËR LËNDËN				
Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Gjithsejtë	
Ligjërata	3	15	45	
Ushtrime	1	15	15	
Kontakte me mësimdhënësin	1	15	15	
Kolekfiume/seminare	10	2	20	
Koha e studimit vetanak	3	15	45	
Përgatitja përfundimtare për provim	10	1	10	
Koha e kaluar ne vlerësime (teste, kuiz, provimi final)	5	5	25	
Vërejtje: 1 ECTS kredi = 25 orë angazhim, p.sh. nëse lënda i ka 7 ECTS kredi studenti duhet të ketë angazhim gjatë semestrit 175 orë		Ngarkesa totale:	175	
Java	Ligjërata		Ushtrime	
	Tema	Orët	Tema	Orët
1	Java e parë: - Nocioni, lënda dhe funksioni i së drejtës penale ndërkombëtare - Aktualiteti i së drejtës penale ndërkombëtare - Mobiliteti i njeriut bashkëkohor - Aspektet e studimit të veprve penale me	3	Nocioni i së drejtës penale ndërkombëtare, lënda e së drejtës penale ndërkombëtare, aspekti juridik, aspekti kriminalo-politik, aspekti kriminologjik, aspekti penologjik	1

	elemente ndërkombëtare - Zhvillimi i së drejtës penale ndërkombëtare - Fillet dhe zhvillimi i së drejtës penale ndërkombëtare ndërkombëtare deri në luftën e parë botërore - Zhvillimi i së drejtës penale ndërkombëtare pas luftës së dytë botërore si e drejtë supernacionale Literatura bazë: Prof. Dr. Ismet Salihu, “E drejta penale ndërkombëtare” Prishtinë 2011, fq.19-47			
2	Java e dytë: - Burimet e së drejtës penale ndërkombëtare - E drejta ndërkombëtare si burim i së drejtës penale ndërkombëtare - Konventat ndërkombëtare - Zakonet ndërkombëtare - Parimet e përgjithshme juridike - Vendimet gjyqësore dhe doktrina e së drejtës ndërkombëtare - Burimet interne të së drejtës penale ndërkombëtare Literatura bazë: Prof. Dr. Ismet Salihu, “E drejta penale ndërkombëtare” Prishtinë 2011, fq.50-60	3	Konventat ndërkombëtare, zakonet ndërkombëtare, parimet e përgjithshme juridike, vendimet gjyqësore dhe doktrina e së drejtës ndërkombëtare	1
3	Java e tretë: - Parimet themelore të së drejtës penale ndërkombëtare - Parimi universal i aplikimit të së drejtës penale ndërkombëtare - Parimi i ligjshmërisë - Parimi non bis in idem - Parimi i përgjegjësisë individuale - Parimi i rëndësisë së kapacitetit zyrtar - Parimi i përgjegjësisë së komandove dhe eprorëve - Mos zbatueshmëria e statutit të kufizimeve - Baza për përjashtimin e përgjegjësisë penale - Urdhërat eprore dhe parashikimi i ligjit Literatura bazë: Prof. Dr. Ismet Salihu, “E drejta penale ndërkombëtare” Prishtinë 2011, fq.63-67 Literatura bazë: Prof. Dr. Olympia Bekou and Ms. Katerina Katsimardou Miarti, “Udhëzimet ndërkombëtare të së drejtës penale”, Qendra për kërkim dhe politikën e së drejtës penale ndërkombëtare”, 2017, fq. 54-66	3	Parimi universal i aplikimit të së drejtës penale ndërkombëtare, parimi i ligjshmërisë, parimi non bis in idem, parimi i përgjegjësisë penale	1

4	Java e katërt: - Kontributi i së drejtës ndërkombëtare në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në fushën e së drejtës penale - Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut në të drejtën penale materiale - Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut në të drejtën e procedurës penale - Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut në të drejtën penitenciare Literatura bazë: Prof. Dr. Ismet Salihu, “E drejta penale ndërkombëtare” Prishtinë 2011, fq.72-112	3	Parimi i legalitetit, ndalesa e dënimeve të vrazhda dhe johumane, abolimi i dënimit me vdekje, prezumpcioni i pafajsisë, non bis in idem, e drejta për gjykim të drejtë dhe gjykatë të pavarur, e drejta për mbrojtje, aktet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të burgosur dhe në paraburgim	1
5	Java e pestë: - Kufijtë e pushtetit represiv të shtetit - Nocioni i pushtetit represiv të shtetit - Territori i shtetit - Hapësirat të cilat nuk janë në sovranitetin e asnjë shteti - Parimet e përcaktimit të pushtetit represiv të shtetit - Teoritë lidhur me përcaktimin e vendit të kryerjes së veprës penale - Çështjet e posaçme lidhur me përcaktimin e vendit të kryerjes së veprës penale Literatura bazë: Prof. Dr. Ismet Salihu, “E drejta penale ndërkombëtare” Prishtinë 2011, fq.113-139	3	Sipërfaqja tokësore, sipërfaqja ujore, hapësia ajrore, deti i hapur, sipërfaqja e Antartikut, parimi territorial, parimi real apo i mbrojtjes,	1
6	Java e gjashtë: - Nocioni, karakteristikat themelore dhe format e ndihmës juridiko-penale ndërkombëtare - Nocioni i ndihmës juridiko-penale ndërkombëtare - Format e ndihmës juridiko-penale ndërkombëtare në kuptimin e gjërë - Ndihma juridiko-penale ndërkombëtare e cila ushtrohet jashtë procedurës penale konkrete - Burimet juridiko-penale ndërkombëtare në kuptimin e gjërë - Burimet kryesore të së drejtës ndërkombëtare lidhur me ndihmën juridiko-penale ndërkombëtare - E drejta e brendshme burim i ndihmës juridiko-penale ndërkombëtare Literatura bazë: Prof. Dr. Ismet Salihu, “E drejta penale ndërkombëtare” Prishtinë 2011, fq.141-151	3	Ekstradimi, ndimha e vogël juridiko-penale ndërkombëtare, cedimi i ndjekjes penal të shtetit të huaj, ekzekutimi i aktgjykimit penal të gjykatës së shtetit të huaj	1
7	Testi i parë Java e shtatë: - Ekstradimi	3	Qëllimi i ekstradimit, obligimi i ekstradimit, parimet e ekstradimit, pengëat për ekstradim lidhur me	1

	- Nocioni dhe qëllimi i ekstradimit - Obligimi i ekstradimit - Konventat ndërkombëtare me të cilat është rregulluar ekstradimi - Parimet themelore të ekstradimit - Pengesat juridike për ekstradim Literatura bazë: Prof. Dr. Ismet Salihu, “E drejta penale ndërkombëtare” Prishtinë 2011, fq.154-182		kryerësin e veprës penale, lloji i veprës penale si pengesë për ekstradim, shkaqet procedurale si pengesë për ekstradim	
8	Java e tetë: - Procedura për ekstradimin e të pandehurve dhe të personave të dënuar - Provat të cilat duhet të mbështesin kërkesën për ekstradim - Sistemi administrativ dhe i përzier i procedurës për ekstradim - Çështjet më të rëndësishme të procedurës së ekstradimit të rregulluara me të drejtën ndërkombëtare dhe me Kodin e procedurës penale të Kosovës - Procedura e ekstradimit në shtetin ku gjendet i pandehuri apo personi i dënuar - Procedura e ekstradimit në shtetin që kërkon ti dorëzohet i pandehuri apo personi i dënuar - Pozita e shtetit në rastet kur i refuzohet lutja për ekstradim - Masat e ngjajshme me ekstradimin - Nocioni dhe rëndësia e të drejtës së azilit Literatura bazë: Prof. Dr. Ismet Salihu, “E drejta penale ndërkombëtare” Prishtinë 2011, fq.183-209	3	Mënyra e komunikimit midis shteteve, privimi i përkohshëm i të pandehurit nga liria dhe paraburgimi me qëllim të ekstradimit, ekstradimi i përkohshëm, dëbimi i të huajit nga shteti (deportimi), rrëmbimi i personit nga shteti, e drejta e azilit sipas legjisllacionit të Kosovës	1
9	Java e nëntë: - Ndihma e vogël juridiko-penale ndërkombëtare - Nocioni dhe qëllimi i ndihmës së vogël juridiko-penale ndërkombëtare - Korniza juridike ndërkombëtare për ndihmën e vogël juridiko-penale - Ndihma e vogël juridiko-penale sipas legjisllacionit të Kosovës - Parimet themelore të ndihmës së vogël juridiko-penale ndërkombëtare - Pengesat juridike për ndihmën e vogël juridiko-penale ndërkombëtare - Pengesat për dhënien e ndihmës së vogël juridiko-penale ndërkombëtare lidhur me kryerësin e veprës penale - Lloji i veprës penale si pengesë për dhënien e ndihmës së vogël juridiko-penale ndërkombëtare - Mbrojtja e interesave shtetërore si	3	Ndihma e vogël juridiko-penale sipas marrëveshjeve bilaterale ndërkombëtare, veprat penale politike dhe ushtarake, veprat penale ekonomike, fiskale dhe revizore, veprat penale për të cilët është paraparë dënimi me vdekje	1

	pengesë për dhënien e ndihmës së vogël juridiko-penale ndërkombëtare - Pengesat procedurale si pengesë për dhënien e ndihmës së vogël juridiko-penale ndërkombëtare Literatura bazë: Prof. Dr. Ismet Salihu, “E drejta penale ndërkombëtare” Prishtinë 2011, fq.210-227			
10	Java e dhjetë: - Veprimet e veçanta të ndihmës së vogël juridiko-penale ndërkombëtare - Ndihma e vogël juridiko-penale tradicionale - Ndihma e vogël juridiko-penale moderne - Marja e sendeve dhe fitimi pasuror të prokuruar me veprën penale - Ndihma juridike me anë të konsullit Literatura bazë: Prof. Dr. Ismet Salihu, “E drejta penale ndërkombëtare” Prishtinë 2011, fq.228-240	3	Dorëzimi i shkresave dhe vendimeve të gjykatave, dorëzimi i sendeve, shkëmbimi i të dhënave nga evidenca e dënimeve, video linqet gjyqësore ndërkombëtare, trupat e përbashkëta hetimore ndërkombëtare, masat e poaçme ndërkombëtare operative	1
11	Java e njëmbdhjetë: - Bashkëpunimi policor ndërkombëtarë - Nocioni dhe rëndësia - Organizatat ndërkombëtare të policisë - Bashkëpunimi ndërkombëtarë dhe ndihma gjyqësore - Detyrimi i përgjithshëm për bashkëpunim - Praktikat e bashkëpunimit - Konfidencialiteti dhe siguria - Mos bashkëpunimi - Disponueshmëria e procedurave sipas ligjit kombëtar - Dorëzimi i personave para gjykatës - Sfidat non bin in idem - Përmbajtja e kërkesave për rrestim dhe dorëzim - Format tjera të bashkëpunimit Literatura bazë: Prof. Dr. Ismet Salihu, “E drejta penale ndërkombëtare” Prishtinë 2011, fq.242-255 Literatura bazë: Prof. Dr. Olympia Bekou and Ms. Katerina Katsimardou Miarti , “Udhëzimet ndërkombëtare të së drejtës penale”, Qendra për kërkim dhe politikën e së drejtës penale ndërkombëtare”, 2017, fq. 80-103	3	Interpoli, Europoli, organizatat tjera ndërkombëtare policore, dorëzimi i personave para gjykatës, format tjera të bashkëpunimit	1

12	Java e dymbdhjetë: - Transferi i procedurës penale e shtetit të huaj - Nocioni dhe arsyeshmëria e transferit të procedurës penale e shtetit të huaj - Burimet juridike ndërkombëtare dhe nacionale në bazë të cilave bëhet transferimi i procedurës penale - Transferi i procedurës penale sipas legjislacionit të Kosovës - Nocioni dhe rëndësia e njohjes ndërkombëtare të aktgjykimit penal - Kontributi i Kombeve të bashkuara dhe të Këshillit të Evropës në njohjen e aktgjykimeve të huaja penale - Njohja e efekteve negative të aktgjykimeve të huaja penale - Njohja e efekteve pozitive të aktgjykimeve penale të huaja Literatura bazë: Prof. Dr. Ismet Salihu, “E drejta penale ndërkombëtare” Prishtinë 2011, fq.258-275	3	Parimet themelore lidhur me transferimin e procedurës penale, kushtet për njohjen dhe ekzekutimin e aktgjykimit penal të shtetit të huaj sipas shkencës së të drejtës penale ndërkombëtare dhe legjislacioneve penale nacionale, njohja e aktgjykimit të huaj penal sipas të drejtës penale të Kosovë	1
13	Testi i dyt Java e trembdhjetë: - Ekzekutimi i aktgjykimit të huaj penal - Nocioni dhe arsyeshmëria e ekzekutimit të aktgjykimit të huaj penal - Burimet juridike të cilët i referohen ekzekutimit të aktgjykimit të huaj penal - Kushtet themelore të cilat duhet të përmbushen për ekzekutimin e aktgjykimit penal - Procedura e ekzekutimit të aktgjykimit penal të huaj - Procedura e ekzekutimit të aktgjykimit penal të huaj sipas kodit të procedurës penale të Kosovës Literatura bazë: Prof. Dr. Ismet Salihu, “E drejta penale ndërkombëtare” Prishtinë 2011, fq.277-298	3	Idetiteti i normave, reciprociteti, dënimi nën minimumin e caktuar nuk mund të ekzekutohet në shtetin e huaj, shtetësia e të dënuarit, pëlqimi i të dënuarit, lloji i veprave penale apo situata e caktuara si pengesë për transferimin e personit për ta mbajtur dënimin në shtetin tjetër	1
14	Java e katërmbdhjetë: - Gjykatat penale ndërkombëtare - Lajmërimi dhe zhvillimi i idesë për themelimin e gjykatës penale ndërkombëtare - Përpjekjet për theelimin e gjykatës penale ndërkombëtare pas Luftës së parë botërore - Zhvillimi i së drejtës penale ndërkombëtare gjatë Luftës së dytë botërore dhe themelimi i gjykatave ndërkombëtare në Nurenberg dhe Tokia	3	Statuti i tribunalit të Hagës, statuti i gjykatës së përhershme penale ndërkombëtare, llojet e veprave penale të cilët janë kompetencë të gjykatës, dënimet, ekzekutimi i dënimeve,	1

	- Zhvillimi i gjykatës penale ndërkombëtare në Hagë për krimet e kryera në territorin e ish-Jugosllavisë (1993) - Themelimi i gjykatës së përhershme penale ndërkombëtare (1998) Literatura bazë: Prof. Dr. Ismet Salihu, “E drejta penale ndërkombëtare” Prishtinë 2011, fq.301-340			
15	Java e pesëmbdhjetë: - Veprat penale, përgjegjësia penale dhe sanksionet penale në të drejtën penale ndërkombëtare - Veprat penale ndërkombëtare sipas kodit penal të Kosovës - Përgjegjësia penale në të drejtën penale ndërkombëtare - Sanksionet penale në të drejtën penale ndërkombëtare Literatura bazë: Prof. Dr. Ismet Salihu, “E drejta penale ndërkombëtare” Prishtinë 2011, fq.343-399 Literatura bazë: Prof. Dr. Olympia Bekou and Ms. Katerina Katsimardou Miarti, “Udhëzimet ndërkombëtare të së drejtës penale”, Qendra për kërkim dhe politikën e së drejtës penale ndërkombëtare”, 2017, fq. 20-45, 68-69	3	Gjenocidi, krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës, agresioni, veprat kundër administratës së drejtësisë	1
LITERATURA				
Literatura bazë: 1.prof. Dr. Ismet Salihu:E drejta penale ndërkombëtare, Prishtinë, 2011 2. Prof. Dr. Olympia Bekou and Ms. Katerina Katsimardou Miarti , “Udhëzimet ndërkombëtare të së drejtës penale”, Qendra për kërkim dhe politikën e së drejtës penale ndërkombëtare”, 2017 Literatura shtesë: --Kodi Penal i Kosovës,Prishtinë, 2013. --Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Prishtinë, 2013. --Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale, Prishtinë, 2010. --Konventa për parandalimin dhe dënimin e krimit të gjenocidit, 1948. --Statuti i Gjykatës penale ndërkombëtare për ish Jugosllavi, 1993. --Statuti i Gjykatës penale ndërkombëtare për Ruandën, 1994. --Statuti i Romës për Gjykatën e përhershme penale ndërkombëtare, 1998. --Zejnullah Gruda, Mrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut I, Prishtinë, 2000. --Zejnullah Gruda, E drejta ndërkombëtare publike, Prishtinë, 2007.				
VËREJTJE				
Për çdo temë mësimore, studentët do të pajisen me materiale të nevojshme në gjuhën shqipe. Në fund të çdo ore mësimore, grupet e caktuara të studentëve do të angazhohen me detyrë apo rast studimi lidhur me temën e ligjëruar. <i>Rezultatet e arritura nga ajo detyrë, grupet e studentëve duhet t'i prezantojnë dhe diskutojnë ato në orën e ushtrimeve.</i>				

VËREJTJE PËR STUDENTIN

- Para së gjithash, studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat shkollore;
- Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe punimet seminarike, të jetë i vëmendshëm në orën mësimore;
- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit në teste dhe provim;
- Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet ti përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimmshënësi për realizimin e hulumtues dhe teknik të punimit;
- Testet dhe provimet vlerësohen individualisht për secilin student. Prandaj, studentet duhet të përqendrohen vetëm në njohuritë personale.
- Shkelja eventuale e këtyre parimeve etike (rregullave) ndëshkohet konform normave të parapara me ligj.

Profesori i lëndës:

Dr.sc. Muhamet Racaj